REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 166/17
Datum 02.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *Ministrisë se Administrates Publike*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **202 16 118 211**

Sa i përket tenderit për **Mirembajtja teknike e ndërtesave qeveritare, per Lot 1, Lot 2 dhe Lot 3**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NPN "Uni-Project"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Rexhep Krasniqi, pn
(Adresa)
Prishtine *10000*
(Vendi) *(Kodi postar)*
[redacted]
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Zt. Besnik Vrella
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
[redacted]
(Adresa elektronike)

1 / 06 / 2017
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

NDËRMARRJA PRIVATE NDËRTIMORE UNI-PROJECT PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

Ne fund, Autoriteti Kontraktues, përsëri është mbështetur ne sqarimet e ofruara nga O.E MSS pa bere asnjë verifikim te çmimit te ofruar sipas nenit 3 dhe nenit 4 te Rregullave per Trajtimin e Çmimeve abnormalisht te ulta por ka pranuar si te mjaftueshme sqarimet e ofruara nga MSS.

Autoriteti Kontraktues, me datën 29 / 05 / 2017, ka shqyrtuar Kërkesën per Ri-shqyrtim duke refuzuar shqyrtimin e tyre me arsyetim se pretendimet tona ankimore janë te pabazuara dhe se MAP ka respektuar nenin 61 dhe nenin 72 te LPP-se duke mos ofruar kundër argumente ligjore ne te gjitha pretendimet tona ankimore te specifikuara ne Kërkesën per Ri-shqyrtim.

Duke u nisur nga fakti qe pretendimet tona ankimore nuk janë shqyrtuar drejte dhe ne mënyrë objektive, i drejtohemi përsëri Organit Shqyrtues te Prokurimit nëpërmjet parashtrimit te Ankesës.

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Kompania 'Uni-Project', pas analizimit dhe studimit te dokumenteve relevante te Autoritetit Kontraktues pas procesit te Ri-vlerësimit te ofertave dhe pas Vendimit te saj per shpalljen e fituesit per Lot 1, 2 dhe Lot 3 per shërbimet e pastrimit ne ndërtesat qeveritare, konsideron se Autoriteti Kontraktues – Ministria e Administrates Publike, ka bere shkelje te dispozitave ligjore te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosovës.

Dispozitat e shkelura nga ***Autoriteti Kontraktues – Ministrisë se Administrates Publike,*** janë mese vijon:

1. *Është shkelur neni 59 i LPP-se (vlerësimi i ofertave);*
2. *Është shkelur neni 61 i LPP-se (çmimi abnormalisht i ulte);*
3. *Është shkelur neni 3 dhe neni 4 i Rregullave per trajtimin e çmimit abnormalisht te ulte*
4. *Është shkelur neni 65 – 72 te Ligjit te Prokurimit Publik; dhe*
5. *Është shkelur neni 1, 6 dhe 7 i Ligjit te Prokurimit Publik*

** *Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kompania 'Uni-Project', pas analizimit te teresishem te dokumenteve relevante te Tenderit per **Mirembajtje teknike ne ndërtesat qeveritare, Lot 1, Lot 2 dhe Lot** 3 konstaton dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues – Ministria e Administrates Publike, ka bere shkelje esenciale dhe substanciale te dispozitave ligjore te kornizës ligjore per prokurim publike duke mohuar te drejtat ligjore te Kompanisë sonë ne fitimin e kontratës publike ne mënyrë te rregullte dhe ligjore.

Pretendimet tona ankimore te drejtuara per shqyrtim tek Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues te